



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

**VENDIM**

Nr. 15, dt. 22.12.2021

**MBI MIRATIMIN PERFUNDIMTAR TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
2022-2024 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes të PBA”, Ligjit për buxhetin e vitit 2022, Udhëzimit nr 7 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 1 datë 17.03.2021 “Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2022-2024”, Vendimit të Këshillit të qarkut nr. 09 datë 01.10.2021 “Mbi miratimin e kërkesave buxhetore për PBA 2022-2024 të rishikuar për Këshillin e Qarkut me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

**VENDOSI**

1. Të miratojë dokumentin perfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit paraprak të PBA 2022-2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi  
Juristi Gj. Kristo  
Sek.K.Qarkut B. Muço

